  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 te LPP dhe nenin 75 te VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 7. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					

---

<b>Datë</b> _____	
-------------------	--



### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Bashkengjitur DST-ve

Specifikimi i Materialeve:

Bashkengjitur DST-ve

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Bashkengjitur DST-ve

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

#### Për materialin KORTEN:

*Analizat kimike me komponentët kimikë, duhet të jenë:*

C % deri në max 0.2,

Mn % deri në max 1.7,

Si % deri në max 0.6,

P % deri në max 0.1,

S % deri në max 0.045.

Materiali korten duhet të jetë sipas standartit S320 GD + Z, EN 10346:2009, me riveshje 140 g/m<sup>2</sup>, si dhe e shoqëruar me CE.

---

***Karakteristikë mekanike teknologjike, duhet të jenë:***

Rm nga 0.00 deri në 15, duhet të jetë minimumi 390,

Reh nga 0.00 deri në 13 duhet të jetë minimumi 320,

A % nga 0.00 deri në 15 duhet të jetë minimumi 17,

theyrja në 180° D duhet të jetë minimumi 3.

Materiali korton duhet të jetë sipas standartit S320 GD + Z, EN 10346:2009, me riveshje 140 g/m<sup>2</sup>, si dhe e shoqëruar me CE.

**Për materialin PLEKSI GLASS:**

Të ketë aftësi të shkëlqyeshme termoformuese.

Të ketë vlerësim ndaj zjarrit B2/Class 4/UL HB.

Transmetimi i dritës të jetë 92%.

Të ketë qëndrueshmëri ndaj motit.

Të jetë rezistente ndaj ndikimeve.

Të jetë rezistues ndaj acideve inorganike.

Temperatura maksimale e funksionimit të vazhdueshëm të jetë 70 °C.

Temperatura maksimale e ndërprerjes së funksionimit të jetë 90°C.

Densiteti të jetë sipas testit të metodës ISO 1183, me vlerë 1.19gr/cm<sup>3</sup>.

Absorbimi i ujit në kushtet 23°C/50%RH (24h) të jetë sipas metodës së testimit ISO 62, me vlerë 0.3%.

Tkurrja e derdhur të jetë sipas metodës së testimit ASTM D-955 me vlerë 0.2 - 0.6 %.

Qëndrueshmëria në tërheqje në 23 °C, sipas metodës së testimit ISO 527-2, të jetë 83 Mpa.

Moduli në tërheqje në 23 °C, sipas metodës së testimit ISO 527-2, të jetë 3200 Mpa.

Moduli i lakimit në 23 °C, sipas metodës së testimit ISO 178, të jetë 3300 Mpa.

Forca goditëse sipas metodës së testimit ISO 178, të jetë 22.1 kj/m.

Konstantja për 1KHz të jetë sipas metodës së testimit DIN 53483, të jetë 3.1.

---

## Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

#### Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Tabela Nr.1	copë	7
2	Tabela Nr.2	copë	5
3	Tabela Nr.3	copë	6
4	Tabela Nr.4	copë	12
5	Tabela Nr.5	copë	5
6	Tabela Nr.6	copë	10

#### Afatet e lëvrimit:

**40 (dyzet) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.**

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

---

## **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës në vlerën 333 333.34 (treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e katër) lekë, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

---

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1.Kopje të çertifikuara të bilanceve të vitit 2018, 2019 dhe 2020 të leshuara nga administrata tatimore, të konfirmuara nga Administrata Tatimore, sipas *legjislacionit në fuqi*.

Kandidatët/Operatorët Ekonomikë Ofertues, të cilët janë në kushtet e nenit 41, gërma c, të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009, duhet të paraqesin në procedurën e prokurimit publik edhe akt ekspertizën e kryer nga Eksperti Kontabël i autorizuar, për të tre vitet e kërkuara, 2018, 2019, 2020.

Ku te paketn ne dy bilance te njepasnjeshme , nuk ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivit

2.Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuar nga Administrata Tatimore të 3 viteve të fundit 2018, 2019, 2020, ku vlera të mos jetë më e vogël se 30% e fondit limit të kontratës.

**3. Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore, ku operatori ekonomik ka selinë.**

---

Ky kriter plotësohet nëpërmjet vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse, (Në fazën e ofertimit plotësohet formularit përkatës, dokumentacioni paraqitet pas shpalljes fitues të operatorit ekonomik).

4. Enti/Autoriteti Kontraktor, rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur në procedurën e prokurimit publik. Në rast deklarimi të pasaktë, do të veprohet konform parashikimeve të Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimin publik".

Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqitet në procedurën e prokurimit publik, deklaratë me shkrim nga administratori i Kandidatit/Operatorit Ekonomik Ofertues.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, ku vlera duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/Enti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet taimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**2.3.2.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin e kontratës. Numri i punonjësve të siguruar, duhet të jetë mesatarisht jo më pak se 8 punonjës, për periudhën Maj 2021 - Korrik 2021.

Lidhur me këtë pikë, kandidati/operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore (Administrata Tatimore), në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar për çdo muaj, sipas legjislacionit në fuqi, për të gjithë periudhën e kërkuar.

Ky kriter plotësohet nëpërmjet vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse, (Në fazën e ofertimit plotësohet formularit përkatës, dokumentacioni paraqitet pas shpalljes fitues të operatorit ekonomik).

**2.3.3.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit publik një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë që, jemi dakort me afatin e levrimit të kontratës.

**2.3.4.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik çertifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, si më poshtë, ose ekuivalente, të lëshuara nga organizma ndërkombëtare ose shoqëri të akredituara në



---

Republikën e Shqipërisë, të cilat duhet të jenë të vlefshme datën e hapjes së procedurës së prokurimit publik:

**ISO 9001:2015** çertifikatën e menaxhimit të cilësisë së punimeve; ose ekuivalente.

**ISO 14001:2015** për sistemin e menaxhimit mjedisor, ose ekuivalente.

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**2.3.5.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit publik, Listëpagesat përkatëse E/Sig-25, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudhën Maj 2021 - Qershor 2021 - Korrik 2021, sipas legjislacionit në fuqi. Ky kriter plotësohet nëpërmjet vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse, (Në fazën e ofertimit plotësohet formularit përkatës, dokumentacioni paraqitet pas shpalljes fitues të operatorit ekonomik).

**2.3.6.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë staf mbështetës ose të kontraktuar me kontratë pune, për realizimin e objektit të prokurimit, të paktën një auditues energjistik, të licensuar nga Agjencia për Efiçensën e Energjisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqiten në tender kontrata e punës/shërbimit, e cila duhet të përfshijë të gjithë kohën e realizimit të kontratës, si dhe çertifikatën që provon çertifikimin e mësipërm.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur, sipas kërkesës së mësipërme për kualifikim, ku çertifikimi duhet të jetë detyrimisht i lëshuar nga Agjencia për Efiçensën e Energjisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky kriter duhet të plotësohet sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**2.3.7.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë në staf të paktën 1 punonjës, si dizenjator dekorator, për të cilin duhet të paraqiten në procedurën e prokurimit publik listëpagesat ku të figurojë me kodin përkatës, si dhe kontrata e punës.

Ky kriter duhet të plotësohet sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**2.3.8.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit publik, një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë, ku të deklarojë se i gjithë stafi i deklaruar në tender dhe makineritë e kërkuara, nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, si dhe do të jenë në dispozicion të këtij objekti, deri në përfundimin e plotë të punimeve.

**2.3.9.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në tender autorizim prodhuesi/distributori të autorizuar, për materialin e kortenit.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Entin/Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Në rast se paraqitet nga distributori i autorizuar, të paraqitet në procedurën e prokurimit publik përveçse sa më sipër, edhe dokumenti që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar.

---

**2.3.10.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë në staf të paktën 1 punonjës, si disenjator grafik dekorator, për të cilin duhet të paraqiten në procedurën e prokurimit publik listëpagesat ku të figurojë me kodin përkatës, si dhe kontrata e punës.

Ky kriter duhet të plotësohet sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**2.3.11.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit publik deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë që, autorizon Entin/Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse mbi të gjithë dokumentacionin e paraqitur në procedurën e prokurimit publik, pranë çdo organi/institucioni/autoriteti që i ka lëshuar ato, në rast se do të lindin dyshime mbi vërtetësinë e tyre.

**2.3.12.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik dokument/çertifikatë të vlefshme, që provon dhe vërteton se shoqëria ofertuese/kandidati është e çertifikuar për realizimin e punimeve me material korten, për të cilin duhet të paraqitet në procedurën e prokurimit publik dokumenti që provon se ofertuesi është i çertifikuar për realizimin e punimeve me material korten, dokument ky i lëshuar në emër të shoqërisë ofertuese/kandidatit ofertues.

**2.3.13.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë në staf të paktën 1 punonjës si montues bordesh në reklama, për të cilin duhet të paraqiten në procedurën e prokurimit publik listëpagesat ku të figurojë me kodin përkatës, si dhe kontrata e punës.

Ky kriter duhet të plotësohet sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**2.3.14.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit publik një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë që, i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit publik është i saktë dhe nuk përmban të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi.

**2.3.15.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit publik *për materialin korten* objekt prokurimi, katalogët/fragmente të katalogëve/dokumentacion, ku të vërtetohet dhe dokumentohet se ky produkt me analizat kimike është dhe plotëson sipas specifikimeve teknike.

Gjithashtu, të provohet se materiali korten është sipas standartit S320 GD + Z, EN 10346:2009, me riveshje 140 g/m<sup>2</sup>, si dhe e shoqëruar me CE.

**2.3.16.** Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë ofertuese mbi vendodhjen e mjeteve dhe pajisjeve, si dhe autorizon AK të bëjë verifikimet përkatëse me apo pa paralajmërim paraprak.

**2.3.17.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme, për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit, si më poshtë:

- a. Sharrë alumini për prerje elementësh për tabelat, 1 copë.
- b. Ploter dixhital për stampimin e reklamave, 1 copë.

- 
- c. Printer për dizenjimin e reklamave, 1 copë.
  - d. Makineri prerëse për adezivat për tabelat reklamuese, 1 copë.
  - e. Frezë 2m x 4m, për prerjen e elementëve për prodhimin e tabelave, 1 copë.
  - f. Lazer për prerjen e pleksi glass, metaleve, inoksit, për shkrime adezive, 1 copë.

Për mjetet/pajisjet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacion që të provojë pronësinë e mjeteve/pajisjeve, kontrata, ose akt çdoganimit, ose fatura tatimore përkatëse, si dhe fotot e tyre, ndërsa për mjete të marra me qira, krahas dokumentacionit të mesipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve, deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Ky kriter plotësohet nëpërmjet vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse, (Në fazën e ofertimit plotësohet formularit përkatës, dokumentacioni paraqitet pas shpalljes fitues të operatorit ekonomik dhe para lidhjes së kontrates).

**2.3.18.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, referuar vendit ku do të kryhet zbatimi i punimeve, duhet të ketë staf mbështetës për realizimin e objektit të prokurimit, një inxhinier mjedisi, të certifikuar nga Institucione Shtetërore për efektet, metodat e vlerësimit mjedisor dhe problemet mjedisore.

Për plotësimin e këtij kriteri, duhet të paraqiten në procedurën e prokurimit publik kontrata e punës/shërbimit, diploma, si dhe certifikata/dokumenti që provon certifikimin e mesipërm, dokument ky i lëshuar nga Institucione Shtetërore.

Ky kriter duhet të plotësohet sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**2.3.19.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik dokument/certifikatë të vlefshme, që provon dhe vërteton se shoqëria ofertuese/kandidati është e certifikuar për realizimin e punimeve me pleksi glass, për të cilin duhet të paraqitet në procedurën e prokurimit publik dokumenti që provon se ofertuesi/kandidati është i certifikuar për realizimin e punimeve me pleksi glass, dokument ky i lëshuar në emër të shoqërisë ofertuese/kandidatit ofertues.

**2.3.20.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues referuar vendit ku do të kryhet zbatimi i punimeve, duhet të ketë staf mbështetës për realizimin e objektit të prokurimit, një person të diplomuar si arkitekt peisazhi, për të cilin duhet të paraqitet në procedurën e prokurimit publik kontrata e punës/shërbimit, si dhe diplomën që provon diplomimin e mesipërm.

Ky kriter duhet të plotësohet sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**2.3.21.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, për të gjithë periudhën e kërkuar në dokumentet e tenderit, punonjësit si më poshtë, të kualifikuar sipas formimit profesional:

1 person përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë në fazën e punimeve.

---

1 person për veglat e dorës manuale dhe ato me energji.  
1 punonjës për repartin e galvanizimit.  
1 person për rrezikun e menaxhimit të agjentëve kimikë.

Për plotësimin e këtij kriteri për kualifikim, duhet të paraqitet në tender kontrata e punës dhe certifikata e formimit profesional lëshuar nga institucione shtetërore/kompani të licensuara në fushën e formimit profesional e njohur dhe miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për kurset e formimit profesional.

**2.3.22.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit publik *për materialin korten* objekt prokurimi, katalogët/fragmente të katalogëve/dokumentacion, ku të vërtetohet dhe dokumentohet se ky produkt është sipas karakterisitkave mekanike teknologjike, në përputhje me specififikimet teknike dhe plotëson kërkesat e AK.

**2.3.23.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik dokument/certifikatë të vlefshme, që provon dhe vërteton se shoqëria ofertuese/kandidati është e certifikuar për realizimin e punimeve me dru masiv, për të cilin duhet të paraqitet në procedurën e prokurimit publik dokumenti që provon se ofertuesi/kandidati është i certifikuar për realizimin e punimeve me dru masiv, dokument ky i lëshuar në emër të shoqërisë ofertuese/kandidatit ofertues.

**2.3.24.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit publik *për materialin pleksi glass* objekt prokurimi, katalogët/fragmente të katalogëve/dokumentacion, ku të vërtetohet dhe dokumentohet se ky produkt është në përputhje dhe plotëson specififikimet teknike.

**2.3.25.** Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë një deklaratë që merr përsipër vendosjen e tabelave me fuqine puntore te tij.

**Dhënia e informacionit të rremë, si dhe plotësimi i shtojcës, duke dhënë informacion të rremë në formularin e vetëdeklarimit, pra mospërputhja e vetëdeklarimit me dokumentacionin e kërkuar, do të procedohet konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.**

Në të gjitha rastet kur është përdorur fjala markë ose emër, njihet njëvlefshmëria/barazvlefshmëria ose ekuivalent.

Mos paraqitja e deklaratave në formën dhe mënyrën e kërkuar, përbën shkak për skualifikim.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I.Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

#### B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

## B: DEKLARATA

### Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1	_____



të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	<b>Po [ ]</b>
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	<b>Po [ ]</b>
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	<b>Po [ ]</b>
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	<b>Po [ ]</b>
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:  a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;  b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	<b>Po [ ]</b>
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	<b>Po [ ] Jo [ ]</b>
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose	<b>Po [ ] Jo [ ]</b>

<p>më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).</p>	
<p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>
<p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>
<p>10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>

## C: DEKLARATA

### Mbi Konfliktin e Interesit

#### Deklarata

